REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS,PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr.786 Prot Himarë, më 21.10.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim relacioni dhe projektvendimi "Për zbatimin e Udhëzimit nr. 701, datë 24.09.2026 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe hapjen e një NIPT-i sekondar të Bashkisë Himarë për deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar"

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË
Sekretarit të këshillit Z. Zaho Dedi

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 751, datë 01.12.2022, i ndryshuar me VKM nr. 592, datë 22.07.2026, dhe Udhëzimit nr. 701, datë 24.09.2026 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, po ju dërgojmë relacionin dhe projektvendimin "Për zbatimin e Udhëzimit nr. 701, datë 24.09.2026 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe hapjen e një NIPT-i sekondar të Bashkisë Himarë për deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar".

Faleminderit për bashkëpunimin.

K R Y E T A R

Vangjel Tavo

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI
Erfili Berberi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS,PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr.7867/1 Prot

Himarë, më 21.10.2026

PROJEKTVENDIM
NR.64 DATË. 21.10. /2026

"PËR ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 701, DATË 24.09.2026 TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE DHE HAPJEN E NJË NIPT-I SEKONDAR TË BASHKISË HIMARË PËR DEKLARIMIN DHE PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE PËR NDIHMËSIT PERSONALË TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR"

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 24, neni 30 dhe neni 54, shkronjat "dh" dhe "n", ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar, VKM nr. 751, datë 01.12.2022 "Për një mbrojtje të veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç dhe ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuara", i ndryshuar me VKM nr. 592, datë 22.07.2026, Udhëzimit nr. 701, datë 24.09.2026 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 670, datë 13.12.2022, "Për procedurën e aplikimit dhe përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Himarë

VENDOSI:

1. Të miratohet zbatimi i Udhëzimit nr. 701, datë 24.09.2026 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe hapja e regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit i një NIPT-i sekondar të Bashkisë Himarë, i cili do të përdoret vetëm për deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve dhe Drejtoria e Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Vangjel Tavo

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI
Erfili Berberi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS,PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr.7867/2 Prot

Himarë, më 24.10.2026

RELACION

"PËR ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 701, DATË 24.09.2026 TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE DHE HAPJEN E NJË NIPT-I SEKONDAR TË BASHKISË HIMARË PËR DEKLARIMIN DHE PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE PËR NDIHMËSIT PERSONALË TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR"

Informacion i përgjithshëm dhe baza ligjore

Me VKM nr. 592, datë 22.07.2026 "Për disa shtesa në vendimin nr. 751, datë 1.12.2022, të Këshillit të Ministrave …", periudha e kujdesit që ndihmësit personalë ushtrojnë ndaj personave me aftësi të kufizuara u njihet si periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë dhe barrëlindjes, me efekte nga data 01.10.2026. Sipas pikës 3/1 të këtij vendimi, bashkitë përcaktojnë listat e ndihmësve personalë dhe çdo muaj llogarisin e kryejnë pagesën e kontributeve, në përputhje me ligjin nr. 9136/2003 dhe udhëzimet e ministrit. Në zbatim të tij, Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka nxjerrë Udhëzimit nr. 701, datë 24.09.2026 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 670, datë 13.12.2022, "Për procedurën e aplikimit dhe përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç"", i cili i shtrin efektet nga data 01.10.2026 dhe i ngarkon Bashkisë Himarë detyrimet e mëposhtme:

a) Përfituesit dhe kushtet.

Përfitojnë ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuara sipas shkronjave "b" dhe "c" të nenit 8 të ligjit nr. 57/2019, si dhe ndihmësit personalë të përfituesve sipas nenit 5 të ligjit nr. 8098/1996, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë, nuk janë të vetëpunësuar dhe nuk janë subjekt i sigurimit shoqëror e shëndetësor. Verifikimi i statusit bëhet nëpërmjet ndërveprimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar me sistemet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ndërsa njësitë administrative i përcjellin bashkisë çdo muaj listën e ndihmësve personalë të verifikuar (pikat 1–3 të kreut II). Në rastet kur verifikimi elektronik nuk është i mundur, strukturat përgjegjëse të bashkisë verifikojnë kushtet mbi bazën e vërtetimit elektronik nga portali e-Albania (pika 6).

b) Hapja e NIPT-it sekondar.

Sipas pikës 4 të kreut II të udhëzimit, për zbatimin e detyrimeve që lidhen me deklarimin dhe pagesën e kontributeve, bashkia hap dhe regjistron pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) një NIPT sekondar, sipas legjislacionit tatimor dhe të sigurimeve shoqërore në fuqi. Ky NIPT do të përdoret vetëm për këtë qëllim, në mënyrë që kontributet e ndihmësve personalë të deklarohen dhe të ndiqen veçmas nga listëpagesat e punonjësve të bashkisë dhe të mos ndikojnë në fondin e pagave dhe sigurimeve të administratës (llogaritë 600–601).

c) Deklarimi dhe pagesa mujore.

Brenda datës 20 të çdo muaji pasardhës, bashkia përgatit listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë, ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe kryen pagesën (pika 5). Për rrjedhojë, deklarata dhe pagesa e parë, për muajin tetor 2026, duhet të kryhen brenda datës 20.11.2026.

d) Bashkëpunimi institucional.

Bashkia bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e udhëzimit (pika 7), ndërsa sipas pikës 4 të udhëzimit, krahas Shërbimit Social Shtetëror, edhe bashkitë ngarkohen me zbatimin e tij. Brenda bashkisë, detyrat ndahen ndërmjet strukturës së shërbimeve sociale (listat dhe verifikimi) dhe Drejtorisë së Financës, Planifikimit të Buxhetit dhe Menaxhimit të Aseteve (NIPT-i sekondar, listëpagesa, deklarimi dhe pagesa).

Efekti financiar dhe pasqyrimi në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Himarë

Sipas pikës 2 të VKM nr. 751/2022, të ndryshuar me VKM nr. 592/2026, efektet financiare për pagesën e kontributeve të ndihmësve personalë përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Për rrjedhojë, ky detyrim nuk financohet nga të ardhurat e veta të bashkisë dhe nuk është parashikuar në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Himarë, as në shpërndarjen e fondeve të miratuar (Qershor 2026, i ndryshuar në shtator), ku programi buxhetor 10430 "Përkujdesja sociale" nuk ka fond të planifikuar për këtë qëllim.

Fondi do të pasqyrohet në buxhet vetëm pas ardhjes së aktit të alokimit/transfertës nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe degës së thesarit, si fond i kushtëzuar (transfertë specifike), dhe pagesat do të kryhen vetëm brenda kufirit të këtij fondi, në përputhje me ligjin nr. 9936/2008 dhe ligjin nr. 10296/2010 për marrjen e angazhimeve.

Për vitin 2026 efekti i plotë është për 3 muaj (tetor–dhjetor 2026). Kontributet e muajve tetor dhe nëntor paguhen brenda vitit 2026 (afatet 20.11.2026 dhe 20.12.2026), ndërsa kontributi i muajit dhjetor paguhet brenda datës 20.01.2027 dhe duhet parashikuar në buxhetin e vitit 2027 dhe në PBA 2027–2029, bashkë me efektin vjetor (12 muaj).

Theksojmë se afatet e pagesës janë detyrim ligjor mujor. Nëse fondi nga Ministria nuk mbërrin përpara afatit të 20.11.2026, bashkia do të njoftojë menjëherë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe nuk do të marrë angazhime pa mbulim financiar.

DREJTORI I FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Besa Xhaferi

DREJTORI I DREJTORISË SË ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Aida Halilaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 4534 Prot Tiranë më 24.03.2026

UDHËZIM

Nr. 101, datë 24/03/2026

"PËR
DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 670, DATË 13.12.2022, "PËR PROCEDURËN E APLIKIMIT DHE PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I MBROJTJES SË VEÇANTË NGA SHTETI, PËR GRATË E PAPUNA, ME TRE APO MË SHUMË FËMIJË TË MOSHËS DERI NË 18 VJEÇ"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 58, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të pikës 3/1, të Vendimit nr. 751, datë 01.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për një mbrojtje të veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 670, datë 13.12.2022, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të titullit të udhëzimit nr. 670/2022, shtohet togfjalëshi "...dhe ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar".

2. Para pikës 1 të udhëzimit bëhet shtesa mbi emërtimin e kreut I, si më poshtë:

"I. Procedura e aplikimit dhe përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç.".

3. Pas pikës 6 të udhëzimit shtohet kreu II, me përmbajtje si më poshtë:

"II. Procedura e aplikimit dhe përfitimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar.

1. Ndihmësve personalë të personave me aftësi të kufizuara, sipas shkronjave "b" dhe "ç", të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe ndihmësve personalë të përfituesve sipas nenit 5 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, periudha e ushtrimit të funksionit

të ndihmësit personal njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë dhe barrëlindjes.

2. Verifikimi i statusit të ndihmësit personal që nuk është ekonomikisht aktiv, nuk është i vetëpunësuar dhe nuk është subjekt i sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, për efekt përfitimi të kontributeve, bëhet nëpërmjet ndërveprimit mes Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar me Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Njësia administrative përcjell çdo muaj pranë bashkisë, listën e ndihmësve personalë të verifikuar nga Regjistri Elektronik Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar.

4. Për zbatimin e detyrimeve që lidhen me deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë, bashkia hap dhe regjistron pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) një NIPT sekondar, sipas parashikimeve të legjislacionit tatimor dhe të sigurimeve shoqërore në fuqi.

5. Bashkia, brenda datës 20 të çdo muaji pasardhës, përgatit listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ndihmësit personalë të cilën ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe kryen pagesën, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

6. Përjashtimisht, në rastet kur nuk është i mundur verifikimi dhe kjo njoftohet nga Shërbimi Social Shtetëror, strukturat përgjegjëse të bashkisë verifikojnë përmbushjen e kushteve mbi bazën e vërtetimit elektronik, të lëshuar përmes portalit e-Albania.

7. Bashkia bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij udhëzimi.".

4. Në pikën 7 të udhëzimit, pas togfjalëshit "Shërbimi Social Shtetëror...", shtohet togfjalëshi "...dhe bashkitë".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 01.10.2026.

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË